



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

-VENDIM

Nr 69 Datë 24.7.09

PER MIRATIMIN E FONDIT PËR BLERJE PAJISJE PENGUES TRAFIKU(ULJE SHPEJTËSIE)

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Hapësinor dhe Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë dhe Drejtoria e Financës «Për miratimin e fondit për blerje pajisje pengues trafiku(ulje shpejtësie)», bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, në ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në ligjin nr 10025 dt. 27.11.2008, «Për buxhetin e vitit 2009», në Udhëzimin e MF nr 2 dt. 12.01.2009 «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009» në VKB nr 12 dt 13.02.2009 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009», mbështetur në kompetencat që ka si dhe me propozim të anëtarëve.

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 230.000 lekë për blerje pajisje pengues trafiku(ulje shpejtësie):
2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezerve i të ardhurave të bashkisë me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet	00	04980	05	Art	6090000	- 230.000	lekë
Shtohet	00	06260	05	Art	602000	+230.000	lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Hapësinor dhe Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë, Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike. dhe NSHP.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gjergji Pendavinji